



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Zyra për Komunikim me Publikun

Raport për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike Janar- Qershor 2026

Regjistri i evidencës së kërkesave të pranuar dhe përgjigjeve të dhëna për qasje në dokumentet publike të Komunës së Mitrovicës duke u bazuar në Ligjin Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike dhe Planin e Veprimit për Transparencë në Komunën e Mitrovicës së Jugut 2023/2027.

Gjatë kësaj periudhe gjashtë mujore Janar- Qershor 2026, Zyra për Komunikim me Publikun, konkretisht Zyratarija Përgjegjëse për Qasje në Dokumente Publike ka pranuar gjithsej 47 kërkesa për qasje në dokumente publike, ku 45 prej tyre janë parashtruar në formë elektronike dhe 2 në formë fizike.

Të gjitha kërkesat e parashtruara për Komunën e Mitrovicës kanë marrë përgjigje brenda afatit të paraparë ligjor, ku 30 prej tyre kanë marrë qasje të plotë, ndërsa 11 qasje të pjesshme dhe 6 janë në proces.

Të dhënat në formë të detajuar për secilën kërkesë për këta gjashtë muaj mund ti gjeni në tabelat e mëposhtme.

Nr	Parashtruesi i kërkesës	Mënyra e parashtrimit të kërkesës	Data e parashtrimit	Data e dërgimit tek drejtoria/zyrtari përkatës për	E vlerësuar si:	Data e kthimit të përgjigjes	Numri i dokumenteve të kërkuara

|--|

01-034/01-0003094/26							Nga njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues rezulton se operatori ekonomik LEMKOS SH.P.K. është shpallur fitues i kontratës. Lidhur me këtë, ju lutem të na ofroni këto informata dhe dokumente: Numrin unik të biznesit (NUI/NUB) të operatorit ekonomik LEMKOS SH.P.K., si dhe dëshminë zyrtare për regjistrimin e tij si biznes aktiv, duke pasur parasysh se nga verifikimi në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) ky emër nuk figuron si biznes i regjistruar. Arsyeimin zyrtar të vlerësimit të ofertave, duke qenë se operatori i shpallur fitues nuk ka ofertën me çmimin më të ulët, ndonëse kjo ka qenë kërkesë e përcaktuar në dokumentacionin e tenderit. Raportin e komisionit vlerësues dhe procesverbalin e vlerësimit të ofertave, nëse ekzistojnë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5.	Ylli Bokshi, Avokat 01-034/01-0003341/26	Elektronike	19.01.2026	20.01.2026	Qasje e Plotë	22.01.2026	Pala ka kërkuar qasje në të dhëna zyrtare të kontaktit për organin e kujdestarisë dhe Qendrën për Punë Sociale. Konkretisht, numrat zyrtarë të telefonit, adresat elektronike email dhe adresat fizike të institucioneve përkatëse.
6.	Tirana Bytyqi, gazetare në Organizatën "Çohu" 01-034/01-0004468/26	Elektronike	26.01.2026	26.01.2026	Qasje e Plotë	30.01.2026	Pala ka kërkuar informacionet lidhur me vërshimet që kanë ndodhur si pasojë e reshjeve të shumta të shiut, dhe lidhur me procedurat dhe masat për dëmshpërblimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet.

7.	Endrit Berani, 01-034/01- 0004853/26	Elektronike	26.01.2026	27.01.2026	Qasje e Pjesshme	30.01.2026	Pala ka kërkuar qasje në informacionin nëse Komuna e Vushtrrisë është ende aksionare në shoqërinë aksionare me përgjegjësi të kufizuar KRM "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë (Kompania Rajonale e Mbeturinave "Uniteti" Sh.A.), si dhe kopje të dokumenteve relevante që e vërtetojnë këtë status aktual, të tilla si: Regjistri aktual i aksionarëve të shoqërisë; Vendimet e Kuvendit Komunal ose organeve të tjera vendimmarrëse për ndryshime në strukturën e aksionarëve (nëse ka pasur ndryshime nga themelimi deri më sot); Statuti i shoqërisë, marrëveshja themeluese ose çdo dokument tjetër që përcakton pronësinë aksionare; Çdo raport, vendim apo korrespondencë zyrtare që konfirmojnë ose përjashtojnë pjesëmarrjen e Komunës së Vushtrrisë si aksionare.
8.	Portali "Jepizë Media" 01-034/01- 0005524/26	Elektronike	30.01.2026	30.01.2026	Qasje e Plotë	11.02.2026	Pala ka kërkuar qasje në dokumente publike në procesverbalin e këtij inspektimi, vendimin e nxjerrë nga ky inspektim, si dhe të gjithë dokumentacionin e dosjes së lejes për ndërtimin e këtij kompleksi banesor. Me 27 janar 2026, Inspektorati i Komunës së Mitrovicës ka ndërmarrë një aksion për vendosjen e shiritave në një kompleks banesor në rrugën "Liqeni" të kompanisë "AZ Building". 1. Pyetje- Duam të dimë çfarë shkelje keni gjetur saktësisht në vendin e ngjarjes? Në cilën dispozitë ligjore jeni bazuar për vendosjen e shiritave për ndaljen e përkohshme të punimeve? A e parasheh ligji që të vendosen shiritat në punishte, edhe në raste kur ka vonesa në pagesën për kështet e lejes së ndërtimit? A mund të na dërgoni procesverbalin e inspektimit? Sipas ligjit, për sa kohë parashihet ndalja e punimeve në këto raste? Për çfarë arsye kanë dalë në vendngjarje edhe zyrtarë që nuk janë inspektorë të ndërtimit?
9.	Jahir Sumiçi, përfaqësues i	Elektronike	03.02.2026	03.02.2026	Qasje e Plotë	23.02.2026	Pala ka kërkuar qasje në informata dhe të dhëna zyrtare në lidhje me; Emrat e shkollave që aktualisht nuk kanë drejtor, Emrat e shkollave që nuk kanë zëvendës drejtor, Emrat e shkollave që udhëhiqen nga ushtrues detyre, si dhe

	Medias "HulumTime" 01-034/01- 0006151/26						periudhën kohore të ushtrimit të këtij funksioni, Emrat e shkollave që kanë mungesë të mësimdhënësve, Emrat e shkollave që kanë psikolog shkolle, Emrat e shkollave që nuk kanë psikolog shkolle, Emrat e shkollave që nuk kanë pedagog shkolle, Emrat e shkollave që nuk kanë sekretar shkolle dhe Emrat e shkollave që nuk kanë personel ndihmës (shfëpiak/mirëmbajtës).
10	Behar Sylja 01-034/01- 0007646/26	Fizike	09.02.2026	Zyrtaria përgjegjëse për qasje në dokumente publike me datë 11.02.2026 ka pranuar kërkesën dhe në të njëjtën datë është përcjell tek Njësia Përgjegjëse	Qasje e Pjesshme	16.02.2026	Pala ka kërkuar qasje në dokumente zyrtare që kanë të bëjnë me të dhe vajzën e tij, sipas dispozitave që i parasheh ligji.
11	"DioBes" Sh.P.K 01-034/01- 0008043/26	Elektronike	11.02.2026	11.02.2026	Qasje e Pjesshme	16.02.2026	Pala ka kërkuar qasje në dokumente publike në lidhje me tenderin me titull: Asfaltimi i rrugëve në Bajgorë, Rashan, Tërstenë, Kutllovc dhe Vllahi - Komuna e Mitrovicës së Jugut në Bashkëfinancim me MMPHI 642-25-5633-5-1-1.
12	Edona Mehulli, gazetare në "Veriu.info" 01-034/01- 0008278/26	Elektronike	11.02.2026	11.02.2026	Qasje e Plotë	16.02.2026	Pala ka kërkuar qasje në përgjigje për uzurpim të parkingut publik në rrugën "Nexhip Dragaj" me material ndërtimor nga Aurora Group, konkretisht qasje në dokumente publike në: 1) Vendimin/et e marra nga Drejtoria e Inspeksionit për këtë rast. 2) Gjorbën dhe shkresat e tjera të lendes nëse ka për këtë rast.

13	Marigona Mehani "Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve" 01-034/01- 0008708/26	Elektronike	13.02.2026	13.02.2026	Qasje e Plotë	20.02.2026	Pala ka kërkuar qasje në lidhje me iniciimin e procedurës për trajtimin e qenve agresivë, më konkretisht: Çfarë lloj procedure është iniciuar, pasi që në sistemin e-prokurimi nuk figuron një aktivitet i tillë? Mbi çfarë baze ligjore është duke u zhvilluar kjo procedure dhe nga cili operator ekonomik, dhe çdo informacion tjetër rreth kësaj procedure?
14	Laurant Berisha, "BIRN" 01-034/01- 0008643/26	Elektronike	13.02.2026	13.03.2026	Qasje e Pjesshme	20.02.2026	Pala përmes pyetësorit ka kërkuar nga Komuna e Mitrovicës qasje në informacione lidhur me zbatimin e Strategjisë për Parandalimin dhe Luftimin e Terrorizmit 2023-2028, me theks të veçantë në 'Parandalimin' si objektiv strategjik dhe qëllimi specifik, si në vijim: 1.Identifikimi i hershëm dhe ndërhyrja e hershme për parandalimin e radikalizmit që mund të çojë në ekstremizëm të dhunshëm dhe terrorizëm. Pyetjet e këtij pyetësori synojnë të evidentojnë ndryshimet, përparimet apo sfidat e reja që kanë ndodhur nga nëntori 2024 e deri më 31 tetor 2025.
15	Flora Çekaj U.D Udhëheqëse e Sektorit Ligjor- NP IHK "INFRAKOS" Sh.A Fushë Kosovë 01-034/01- 0009928/26	Elektronike	23.02.2026	23.02.2026	Qasje e Pjesshme	27.02.2026	Pala ka kërkuar qasje në dëshminë e vdekjes së të paditurës që të identifikojnë trashëgimtarët.

16	Avokate Fitore Troshupa- Maloku 01-034/01- 0012509/26	Elektronike	05.03.2026	05.03.2026	Qasje e Pjeshme	09.03.2026	Pala ka kërkuar të pajiset me kopje zyrtare të raporteve, procesverbaleve dhe çdo dokumentacioni relevant lidhur me rastin e një qytetareje nga Qendra për Punë Sociale.
17	Rizah Avdiu 01-034/01- 0012751/26	Elektronike	09.03.2026	09.03.2026	Qasje e Plotë	13.03.2026	Pala ka kërkuar qasje në letër reference në lidhje me tenderin furnizimi dhe instalimi me materiale elektrike në objektin Qendra për mbrojtjen e dhunës në familje me numër të prokurimit 642-24-10762-1-3-6.
18	Jahir Sumçi, gazetar në Hulum Time Media 01-034/01- 0012483/26	Elektronike	07.03.2026	08.03.2026	Qasje e Plotë	13.03.2026	Pala ka kërkuar sqarim dhe qasje në dokumente lidhur me procesin e përzgjedhjes së "Mësimdhënësit të Dalluar" në Komunën e Mitrovicës së Jugut për vitin shkollor 2025/2026.
19	Mirselda Kile Unioni i Bashkive Shqiptare në Rajon 01-034-01- 0013180/26	Elektronike	11.03.2026	11.03.2026	Qasje e Pjeshme	17.03.2026	Pala ka kërkuar qasje në dokumente publike si; Urdhri i emërimit të Kryetarit dhe Karta e identitetit të Kryetarit.
20	Liridon Demiraj, inxhinier i Hidro teknikës, Komuna e Istogut 01-034/01- 0015494/26	Elektronike	24.03.2026	25.03.2026	Qasje e Plotë	27.03.2026	Pala ka kërkuar qasje në një kopje të skanuar të vendimit për lëshimin e lejes ndërtimore për projektin e qendrës tregtare "Art Mall" në Mitrovicë.

21	Uvejs avokat Mirovica 01-08-034/01- 0016759/26	Gashi, nga	Fizike	31.03.2026	01.04.2026	Qasje e Plotë	20.04.2026	Pala ka kërkuar qasje në dokumente publike lidhur me projektin e investitorit Arsi Company dhe atë të gjitha dokumentet që posedon DPU, përfshirë aplikimin për leje ndërtimi, lejen e ndërtimit, kontrollin e inspektorëve komunal gjatë fazës së ndërtimit, raportet e lëshuara nga inspektorët, aplikimin për pranim teknik, raportet për pranim teknik, vendimin për pranimin teknik dhe çdo dokument tjetër të kësaj natyre që lidhen me objektin e ndërtuar nga investitori.
22	Jahir gazetar HulumTime Media 01-034/01- 0017359/26	Sumiçi, në	Elektronike	01.04.2026	02.04.2026	Qasje e Plotë	07.04.2026	Pala ka kërkuar qasje në informata lidhur me zëvendësimin e Ramadan Beshiri, i cili ishte profesor i lëndës së sociologjisë në SHML "Hasan Prishtina" dhe tani është emëruar në pozitën e Drejtorit për Mirëqenie Sociale, konkretisht; A ka ndërmarrë Drejtoria Komunale e Arsimit masa për zëvendësimin e profesorit në fjalë? 2. Nëse PO: - o Kush është personi i angazhuar si zëvendësim? - o Cilat janë kualifikimet profesionale dhe akademike të tij/saj? - o Në çfarë baze ligjore dhe kontraktuale është bërë ky angazhim? 3. Nëse JO: - o Cilat janë arsyet e mos zëvendësimit? - o Si është duke u garantuar zhvillimi i rregullt i procesit mësimor për nxënësit?
23	OJQ- Reconciliation Empowering Communities 01-034/01- 0017484/26	REC-	Elektronike	02.04.2026	02.04.2026	Qasje e Plotë	08.04.2026	Pala ka kërkuar qasje në dokumente publike përkatësisht informacione në lidhje me punësimin dhe qasjen në institucione për persona me aftësi të kufizuara duke bashkëngjitur pyetësorin me pyetje konkrete si: Numri i personave me aftësi të kufizuara të punësuar në Komunë, politikatat dhe masat e ndërmarra për punësim gjatë vitit 2025, nivelin e qasjes fizike në objektet komunale, shërbimet dhe format e përfshirjes për personat me aftësi të kufizuara.

24	Vigan Behluli 01-034/01- 0017836/26	Elektronike	03.04.2026	03.04.2026	Qasje e Plotë	07.04.2026	Pala ka kërkuar dokumente dhe informata lidhur me Planin Zhvillimor Komunal të Komunës së Mitrovicës së Jugut 2020- 2028.
25	Jahir Sumiçi, gazetar në Hulum Time Media 01-034/01- 0017796/26	Elektronike	02.04.2026	02.04.2026	Qasje e Pjesshme	08.04.2026	Pala ka kërkuar qasje në dokumente publike, konkretisht ka kërkuar që të njoftohet paraprakisht dhe në mënyrë të vazhdueshme për takimet dhe aktivitetet zyrtare të kryetarit të komunës, aktivitetet dhe vizitat e nënkryetarit, organizimet, vendimet dhe njoftimet e drejtorive komunale, ngjarjet dhe zhvillimet me interes publik për qytetarët, mbledhjet e komisioneve komunale në të gjitha rastet kur ato janë të hapura për publikun dhe mediat.
26	Jahir Sumiçi 01-034-01- 0019709/26	Elektronike	12.04.2026	14.04.2026	Qasje e Plotë	17.04.2026	Pala ka kërkuar qasje në dokumente dhe informacion zyrtar lidhur me projektin e ndërtimit të çerdhes në lagjen Tavnik.
27	Vanesa Isufi 01-034/01- 0019748/26	Elektronike	14.04.2026	14.04.2026	Qasje e Pjesshme	17.04.2026	Pala ka kërkuar qasje në informata apo dokumentet ku dëshmohet arsyeja e mos pagesës së plotë të pagës së muajit Gusht 2025.
28	Jahir Sumiçi, Hulum Time Media 01-034-01- 0020870/26	Elektronike	16.04.2026	17.04.2026	Qasje e Plotë	21.04.2026	Pala ka kërkuar qasje në informata dhe dokumente në lidhje me deklarinimin publik të Drejtorit për Mirëqenie Sociale, Ramadan Beshiri, se gjatë periudhës tre mujore është shënuar një ulje prej 2.94% e numrit të familjeve përfituese të asistencës sociale; Numrin e saktë të familjeve përfituese të asistencës sociale për vitin 2025 (i ndarë sipas muajve, nëse është e mundur); Numrin e familjeve përfituese për tre muajorin e parë të vitit 2026; Paraqitjen grafike (grafikonin) e ndryshimit të përqindjes së familjeve përfituese, duke reflektuar trendin e rënies së raportuar;

								Sqarimet zyrtare mbi shkaqet dhe faktorët që kanë ndikuar në këtë ulje, duke përfshirë politikat, vendimet administrative apo ndryshimet në kriteret e përfuturit.
29	Redaksia "Mitropol Media" 01-034/01- 0020876/26	Elektronike	16.04.2026	16.04.2026	Qasje e Plotë	21.04.2026		Pala ka kërkuar qasje në dokumente publike dhe atë shkicën e planifikimit urbanistik për lagjet "Nexhip Dragaj", "Ferat Dragaj" dhe "Ukshin Kovaqica".
30	Jahir Sumiçi, gazetar në HulumTime Media 01-034/01- 0020874/26	Elektronike	16.04.2026	16.04.2026	Qasje e Plotë	08.05.2026		Pala ka kërkuar qasje në informata dhe dokumente publike në lidhje me deklaratimet publike për angazhimin e këshilltarëve të jashtëm në Drejtorinë e Shëndetësisë, kërkojmë nga Komuna e Mitrovicës së Jugut të na ofrojë informacionet si më poshtë: Dokumentin zyrtar (vendim/kontratë/akt administrativ) mbi bazën ligjore të angazhimit të këshilltarëve të jashtëm në Drejtorinë e Shëndetësisë; Listën e drejtorive komunale që kanë angazhuar këshilltarë të jashtëm (nëse ka më shumë se një drejtori); Emrat dhe mbiemrat e të gjithë këshilltarëve të jashtëm të angazhuar në secilën drejtori veç e veç; Pozitën/fushën e secilit këshilltar të angazhuar; Datën e fillimit dhe kohëzgjatjen e kontratës së secilit angazhim; Vlerën financiare të kontratës ose kompensimin mujor për secilin këshilltar.
31	Hasan Dervari, "Gazeta Online" Prishtinë 01-034/01- 0021481/26	Elektronike	17.04.2026	17.04.2026	Qasje e Plotë	08.05.2026		Pala ka kërkuar qasje në dokumente publike lidhur me marrëveshjen e Komunës së Mitrovicës me Fondin Kosovar të Eficiencës nëse po, Sa është shuma e marrëveshjes, sa ka përfutur komuna nga këto marrëveshje, a ka person kontaktues që mbikëqyr punën e tyre, sa ka obligime komuna ndaj Fondit.

32	Arbnora Pillana, gazetare Kosova Press 01-034-01- 0021972/26	Elektronike	21.04.2026	21.04.2026	Qasje e Plotë	24.04.2026	Pala ka kërkuar informacione në lidhje me kamerat e sigurisë të vendosura në hapësirat publike të Komunës së Mitrovicës së Jugut, procedurat e tenderimit për këtë projekt, si dhe kompaninë fituese.
33	Edona Mehollli, gazetare Veriu.info 01-034/01- 0022236/26	Elektronike	22.04.2026	22.04.2026	Qasje e Plotë	24.04.2026	Pala ka kërkuar qasje në: Lejen e lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit për kompleksin banesor që po ndërtohet nga Xani Exclusive Building në lagjen Bair. Gjitha shkresat që ndërlidhen me lejen, para dhe pas lëshimit të saj.
34	Gazmend Morina, në Gazetar Veriu.info 01-034/01- 0026252/26	Elektronike	06.05.2025	06.05.2026	Qasje e Pjesshme	08.05.2026	Pala ka kërkuar qasje në: 1) Dosjen e tenderit për asfaltimin e rrugëve në fshatrat Bajgorë, Rashan, Tërstenë, Kutilovc dhe Vllahi. 2) Gjithë dosjen e ofertimit nga grupi i operatorëve ekonomike Dio Bes Sh.P.K. dhe Eurokos Holding Sh.P.K. Këtu përfshihet edhe qasje në dokumentet aplikuese për stafin e tyre, përfshirë edhe diplomat e stafit, kontratat me stafin, si dhe referencat e këtij grupi të operatorëve ekonomik për punët që i ka kryer në të kaluarën dhe që i ka përdorur si reference për aplikim. Për shkak se ne aplikim ka përdorur si staf shtetas të huaj, për ne është me rëndësi t'i kemi gjitha shkresat për ta, në mënyrë që të sqarohet çështja e nostrifikimit të diplomave të tyre.
35	Jahir Sumiçi, në Gazetar HulumTime Media	Elektronike	10.05.2026	13.05.2026	Qasje e Pjesshme	28.05.2026	Pala ka kërkuar qasje në informata dhe dokumente zyrtare lidhur me orët mësimore të drejtorëve të emëruar në komunë, të cilët paraprakisht kanë qenë të angazhuar si mësimdhënës në institucionet arsimore.

	01-034/01-0027593/26								
36	Jahir Sumiçi, gazetar në HulumTime Media 01-034/01-0031030/26	Elektronike	30.05.2026	01.06.2026	Qasje e Plotë	08.06.2026	Pala ka kërkuar qasje në informata në lidhje me kompensimin e mjekëve në angazhimet e tyre për kujdestari dhe atë; A janë kompensuar mjekët për kujdestaritë e realizuara në QKMF "Nexhat Çuni"; Nëse jo, cilat janë arsyet konkrete të mos kompensimit; Sa muaj kanë mbetur pa u ekzekutuar pagesat; Kur pritet të realizohen këto obligime financiare ndaj stafit mjekësor.		
37	Gazmend Morina, në Gazetar Veriu.info 01-034/01-0034036/26	Elektronike	11.06.2026	12.06.2026	Qasje e Plotë	16.06.2026	Pala ka kërkuar qasje në; 1) Vendimet për ndërprerje të punimeve për "Afri Univerzal", "FINN AB Group" dhe "Aurora Group", 2) Procesverbalet e inspektimeve të këtyre tre rasteve.		
38	Edona Mehollin, në Gazetare Veriu.info 01-034/01-0034034/26	Elektronike	10.06.2026	12.06.2026	Qasje e Plotë	16.06.2026	Pala ka kërkuar qasje në: 1) Vendimet për ndërprerje të punimeve për "Xani" dhe "Berani Group", 2) Procesverbalet e inspektimeve të këtyre dy rasteve.		
39	Jahir Sumiçi, Kryeredaktor në HulumTime Media 01-034/01-0034597/26	Elektronike	15.06.2026	16.06.2026	Qasje e Plotë	22.06.2026	Pala ka kërkuar qasje në dokumentet dhe të dhënat në vijim: 1.Raporti i plotë buxhetor për Çerdhen e Qytetit, shkollat fillore dhe shkollat mesme në Komunën e Mitrovicës, sipas buxhetit të miratuar nga Kuvendi Komunal për vitin 2025 për vitin fiskal 2026. 2.Raporti i plotë financiar dhe buxhetor aktual për këto institucione pas të gjitha ndryshimeve, transferimeve apo ridestimeve buxhetore të bëra gjatë vitit 2026.		

							3.Vendimet, procesverbalet, propozimet, kërkesat apo aktet administrative që kanë shërbyer si bazë ligjore dhe procedurale për transferimin, zvogëlimin apo ridestininimin e mjeteve financiare të institucioneve edukativo-arsimore. 4.Tabelën krahasuese të buxhetit fillestar dhe buxhetit aktual për secilën çerdhe, shkollë fillore dhe shkollë të mesme, duke paraqitur qartë shumën e mjeteve të larguara, të transferuara apo të shtuara. 5.Të dhënat mbi destinimin përfundimtar të mjeteve të transferuara, përfshirë drejtoritë, projektet dhe kategoritë buxhetore që kanë përfituar nga këto mjete.
40	Hasan Dervari Gazeta Online- Prishtinë 01-034/01- 0035216/26	Elektronike	17.06.2026	18.06.2026	Qasje e Plotë	23.06.2026	Pala ka kërkuar qasje në: 1. Në kuadër të institucionit tuaj a ka persona që janë në pushim mjekësor 2. A ka zyrtar në pushim të lehonisë 3. A ka zyrtar në pushim pa pagesë Kërkesa ka të bëjë me të gjitha institucionet që i menaxhoni përfshirë Institucionet Arsimore dhe Shëndetësore.
41	Shpat Neziri, Kryetar i Forumit Rinor të LDK-së 01-034/01- 0035324/26	Elektronike	18.06.2026	19.06.2026	Qasje e Plotë	24.06.2026	Pala ka kërkuar qasje mbi mënyrën e dhënies në shfrytëzim të këtyre hapësirave publike dhe përfitimet që realizon Komuna nga to. Konkretisht; 1.Vendimin për dhënie në shfrytëzim të hapësirave reklamuese në stacionet e autobusëve; 2.Kontratën/kontratat e lidhura me operatorin/operatorët ekonomikë; 3.Procedurën e ndjekur për përzgjedhjen e operatorit (fiesë publike, tender, negociim, etj.); 4.A fatin e kontratës dhe kushtet e shfrytëzimit;


							5.Vlerën financiare të kontratës dhe detyrimet financiare ndaj Komunës; 6.Evidencën e pagesave të realizuara nga operatori (të hyrat për Komunën); 7.Listën e stacioneve të autobusëve të përfshira në kontratë; 8.Çdo vendim të Kuvendit Komunal ose të Kryetarit që lidhet me këtë çështje.
42	Shkëlqim Ibrahim, Anëtar i Kuvendit Komunal të Mitrovicës nga radhët e PDK-së 01-034/01-0035547/26	Elektronike	22.06.2026	22.06.2026	Në proces		Pala ka kërkuar qasje në dokumentacionin e plotë lidhur me projektin e konstruksioneve metalike dhe saksive me lule të vendosura në ishujt e qytetit të Mitrovicës; 1.Vendimet për iniciimin dhe aprovimin e projektit; 2.Kërkesat, procedurat e prokurimit dhe i gjithë dokumentacioni përcjellës i procedurës; 3.Dosja e tenderit, përfshirë specifikat teknike dhe paramasat/parallogaritë; 4.Procesverbalet, raportet e vlerësimit dhe vendimi për dhënie të kontratës; 5.Kontrata e lidhur me operatorin ekonomik; 6.Dokumentet mbi mbikëqyrjen, pranimin teknik apo raportet e realizimit të projektit; 7.Faturat, pagesat e realizuara dhe çdo dokument tjetër financiar që lidhet me këtë projekt.
43	Jahir Sumiçi, Hulum Time Media, 01-034/01-0037408/26	Elektronike	24.06.2026	01.07.2026	Në proces		Pala ka kërkuar qasje dhe kopje elektronike të dokumenteve si më poshtë: 1.Të gjitha procesverbalet e mbledhjeve të Komisionit të Aksionarëve të NPL “Tregu” Sh.A. të mbajtura gjatë vitit 2026. 2.Procesverbalin e mbledhjes në të cilën është shqyrtuar dhe miratuar riemërimi i z. Musa Preteni në pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv të NPL “Tregu” Sh.A. 3.Vendimin për riemërimin e z. Musa Preteni në pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv.

							4. Të gjitha materialet përcjellese që i janë paraqitur Komisionit të Aksionarëve lidhur me këtë riemërim, përfshirë propozimet, raportet, rekomandimet, arsyetimet dhe dokumentet tjera relevante që kanë shërbyer si bazë për vendimmarrje.
							5. Listën e pjesëmarrësve dhe nënshkrimet e anëtarëve të Komisionit të Aksionarëve në mbledhjen ku është marrë vendimi për riemërimin e z. Musa Preteni.
							6. Çdo vendim tjetër të Komisionit të Aksionarëve gjatë vitit 2026 që lidhet me mandatin, kontratën apo vazhdimin e angazhimit të Kryeshefit Ekzekutiv të NPL “Tregu” Sh.A.
44	Gazmend Morina, në Gazetar Veriu.Info 01-034/01- 0037310/26	Elektronike	29.06.2026	01.07.2026	Në proces		Pala ka kërkuar qasje në: 1) Marrëveshjen/Kontratën mes Komunës së Mitrovicës dhe kompanisë që e ka marr në shfrytëzim këtë pronë. 2) Marrëveshjen/Kontratën me të cilën i është vazhduar afati i shfrytëzimit. 3) Marrëveshjen/Kontratën apo çfarëdo dokumenti zyrtar me të cilin përcaktohen obligimet e marrësit në shfrytëzim të kësaj prone. 4) Të gjitha shkresat tjera të lëndës që ekzistojnë për këtë rast.
45	Gazmend Morina, në Gazetar Veriu.Info 01-034/01- 0037304/26	Elektronike	29.06.2026	01.07.2026	Në proces		Pala ka kërkuar qasje në: 1) Çdo vendim të inspektoreve për ndërprerje të punimeve në dhe mbi këtë qendër prej 1 janar 2025 e deri me 29 qershor 2026. 2) Çdo vendim për leje për kryerje të punimeve në dhe mbi këtë qendër prej 1 janar 2025 e deri me 29 qershor 2026. 3) Çdo dokumente/shkresë që Komuna e Mitrovicës, përfshirë edhe Drejtorinë për Inspektion dhe Drejtorinë për Urbanizëm ka LESHUAR për kompaninë që menaxhon këtë qendër prej 1 janar 2025 e deri me 29 qershor 2026.

46	Edona Mehulli, Gazetare në Veriu.Info 01-034/01- 0037307/26	Elektronike	29.06.2026	01.07.2026	Në proces	Pala ka kërkuar qasje në këto dokumente: 1) Të gjitha kërkesat për leje ndërtimore të objekteve banesore pranë Liqenit Akumulues në Mitrovicë për periudhën 1 janar 2026 deri me 25 qershor 2026. Pra, gjitha kërkesat pavarësisht statusit të tyre aktual procedural. 2) Vendimet për refuzim apo aprovim të këtyre kërkesave për leje ndërtimore. Këtu fjala është për ato kërkesa që nuk janë në procedure, por është marr vendim aprovues apo refuzues për to.
47	Jahir Sumiçi, HulumTime Media, 01-034/01- 0037388/26	Elektronike	30.06.2026	01.07.2026	Në proces	Pala ka kërkuar qasje në dokumentet si në vijim: 1. Listën e plotë të të gjitha pagesave të realizuara nga nënprogramet buxhetore të Drejtorisë së Arsimit për mbulimin e obligimeve të Drejtorisë së Infrastrukturës, duke përfshirë datën, shumën, përshkrimin e pagesës dhe nënprogramin buxhetor nga i cili janë realizuar. 2. Të gjitha urdhërpagesat, autorizimet e pagesave, voucher-at financiarë dhe dokumentet e tjera financiare që dëshmojnë realizimin e këtyre pagesave. 3. Çdo vendim, shkresë, memorandum, dakordim, procesverbal apo dokument tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është vendosur që obligimet e Drejtorisë së Infrastrukturës të financohen nga buxhetet e nënprogrameve të Arsimit. 4. Dokumentacionin që dëshmon zotimin e përmendur në përgjigjen tuaj, sipas të cilit Drejtoria e Infrastrukturës është zotuar se deri në fund të vitit këto obligime do të mbulohen nga buxheti i Komunës, përkatësisht nga buxhetet e drejtorive komunale përkatëse. 5. Evidencën kontabël ose raportin financiar që tregon ndikimin e këtyre pagesave në buxhetin e secilit nënprogram të Arsimit.

Vërejtje:

Të gjitha kërkesat e parashtruara si nga gazetarë, shoqëri civile, organizata buxhetore, individ, studentë apo të tjerë janë të arkivuara si dokumente fizike dhe dokumente elektronike.



02/07/2026